

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

NISMA PËR TRANSPARENCËN E INDUSTRIVE NXJERRËSE



Raporti për NTIN 2009

Përkthyer nga anglishtja

Në rast paqartësie, ju lutemi refererohuni versionit anglisht



42, avenue Montaigne
75008 Paris - FRANCE

1 Heddon Street
London W1B1BD - UK

©Fair Links SARL – RCS 501284764





42, avenue Montaigne
75008 Paris - FRANCE
Tel : +33 (0)1 44 07 00 00
Fax : +33 (0)1 44 07 00 10

Grupi i Punës i Nismës për
Transparencën e Industrive
Nxjerrëse (NTIN)
TIRANË – SHQIPËRI

Presidentit të Grupit të Punës të NTIN për Shqipërinë

LËNDA: Raporti për NTIN 2009 Shqipëri

I dashur Zotëri,

Nisma për Transparencën e Industrive Nxjerrëse (NTIN) synon të ndihmojë për rritjen e transparencës dhe besueshmërisë në sektorin e naftës, gazit dhe minierave. Republika e Shqipërisë aderoi në këtë Nismë-NTIN në Maj 2009 dhe, në 20 Mars 2010, u pranua si vend kandidat.

Në Dhjetor 2008, u krijua paraprakisht një Grup Pune i ngarkuar me zbatimin e NTIN në Shqipëri. Ky Grup përbëhet nga palë të ndryshme të interesuara pjesëmarrëse në këtë Nismë (Shteti, kompanitë dhe shoqëria civile). Në punën e tij, Grupi i Punës mbështetet te Sekretariati Teknik i krijuar në Janar 2011.

Fair Links u përzgjedh me tender si ekspert i pavarur me qëllim që të grumbullojë, kuadrojë dhe përpilojë të dhëna për:

- (i) të ardhurat që Shteti ka deklaruar se ka marrë nga kompanitë nxjerrëse në vitin 2009;
- (ii) pagesat që kompanitë kanë deklaruar se kanë bërë në të njëjtin vit.

Sipas Rregullave të NTIN, të ardhurat e Shtetit dhe pagesat përkatëse që kanë bërë kompanitë përkufizohen si flukse të Perfitimeve-avantazheve (benefit streams=zërat e pagesave të kompanive dhe të ardhurave të shtetit).

Ky Raport u përgatit në përputhje me përvojat më të mira ndërkombëtare për raportimin në kuadrin e NTIN. Përvoja të tilla kërkojnë në mënyrë të veçantë një shkallë të lartë integriteti dhe respektimin e etikës, si dhe ndjekjen në mënyrë rigoroze të procedurave për të siguruar përshtatshmëri, cilësi dhe paanësi në punë, përfshirë procedurat për drejtimin, administrimin e burimeve dhe kontrollin e brendshëm.

Në Raport diskutohet për këto çështje kryesore faktike dhe analitike:

Pjesa I. Kuadri kombëtar i industrive nxjerrëse shqiptare

Pjesa II. Alternativa e Grupit të Punës lidhur me Objektivin e miratuar të Raportit për NTIN 2009 Shqipëri

Pjesa III. Natyra dhe shtrirja e punës që kemi bërë

Pjesa IV. Kuadrimi (bashkërendimi, përputhja) i të dhënave për sektorin e naftës

Pjesa V. Kuadrimi i të dhënave për sektorin e minierave

Pjesa VI. Konkluzione: komente dhe rekomandime

Paris, 30 Prill 2011

Anton Mélard de Feuarent

Partner

Pjesa I. Kuadri kombëtar i industrive nxjerrëse shqiptare

A. Përshkrimi i sektorit nxjerrës në Shqipëri

Në Shqipëri, sektori nxjerrës përfaqësohet kryesisht nga sektori i naftës për industrinë, i cili kontribuon në pjesën më të madhe dhe në rritje të të ardhurave të Shtetit, dhe nga sektori i mesëm dhe i vogël i minierave, i cili mbështetet kryesisht te nxjerrja e kromit, bakrit dhe nikelit.

▪ Sektori i naftës

Që nga viti 1990, marrëveshje të ndryshme naftë janë lidhur me kompani ndërkombëtare, ndërsa është zbatuar kuadri ligjor (Ligji për Naften Nr. 7746, datë 27 Korrik 1993, “Zbulimi dhe prodhimi”, si dhe Ligji Nr. 7811, datë 12 Prill 1994, “Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve”) për thithjen e investitorëve të huaj.

Në vitin 2009, sektori i naftës përfaqësohej nga:

→ Dy kompani ndërkombëtare të prodhimit në tokë:

- Bankers Petroleum (rreth 8 000 barrele/ditë)
- Stream Oil & Gas (rreth 1 500 barrele/ditë)

→ Një Kompani Kombëtare e Naftës, si partnere e kompanive private të naftës dhe Agjenci Shtetërore e Grumbullimit:

- Albpetroli

→ Gjashtë kompani ndërkombëtare në fazën e zbulimit:

- Capricorn Albania (filial i Cairn)
- IEC Visoka
- Island International Exploration (filial i San Leon Energy)
- Manas Adriatic (filial i DWM)
- Sherwood International (filial i Bankers Petroleum)
- Sky Petroleum

Duke patur parasysh rëndësinë e projekteve të zbulimit dhe investimet gjithnjë në rritje të kompanive të huaja në sektorin e naftës, me sa duket Shqipëria ka potencial për ta rritur ndjeshëm prodhimin e saj të naftës në të ardhmen.

Pagesat që i bëjnë Shtetit kompanitë private përbëhen nga **bonuset e nënshkrimit** (për lejet e zbulimit), **rentat minerare** dhe **tatimin-fitimi e shoqërive**. Përveç kësaj, Albpetroli merr **bonuse të nënshkrimit** (për lejet e prodhimit), si dhe **pjesën nga ndarja e prodhimit që i caktohet Kompanisë Kombëtare të Naftës**, që përfshin veçanërisht rikuperimin e investimeve të mëparshme të Albpetrolit (prodhimi i vlerësuar); dhe Albpetroli i rishpërndan disa të ardhura Shtetit nëpërmjet pagesës së **tatimit mbi fitimin e shoqërive** dhe të **dividendëve**.

Pagesat e deklaruara që kompanitë e naftës kanë bërë dhe të ardhurat e deklaruara nga Shteti jepen në faqen 15 të këtij Raporti.

▪ Sektori i minierave

Sektori i minierave rregullohet me Ligjin Minerar të Shqipërisë Nr. 7796 (datë 17 Shkurt 1994). Ky ligjeron dhe rregullon privatizimin e gjithë veprimtarive minerare në Shqipëri nëpërmjet dhënies së lejeve të zbulimit dhe koncesioneve të prodhimit kompanive vendase dhe të huaja. Në vitin 2010, kuadri ligjor u përditësua. Sidoqoftë, kjo gjë nuk ndikon te viti financiar që merret në shqyrtim në këtë Raport.

Për vitin 2009, prodhimi minerar lidhej kryesisht me nxjerrjen e tre mineraleve:

→ Krom

Ndër kompanitë prodhuese të kromit përfshiheshin:

- *Albanian Chrome* (ACR – filial i Decometal, ish *Darfo*) – aktor kryesor, që siguronte rreth 1/3 e produkteve të përgjithshme kombëtare të kromit
- Aktorë të tjerë të shumtë të mesëm dhe të vegjël

→ Bakër

Ndër kompanitë prodhuese të bakrit përfshiheshin:

- Ber Alb – aktor kryesor
- Disa aktorë të tjerë të mesëm dhe të vegjël

→ Nikel

Ndër kompanitë prodhuese të nikelit përfshiheshin:

- Disa aktorë të mesëm dhe të vegjël

Pjesën më të madhe të pagesave, që i bëjnë kompanitë prodhuese Shtetit, e përbëjnë **rentat minerare, tatim-fitimi i shoqërive dhe taksat për sipërfaqen**.

Në vitin 2009, kompanitë kryesore të përfshira në procesin e zbulimit në Shqipëri, si aktorë ndërkombëtarë, ishin:

→ Krom

- Empire Mining
- Jab Resources

→ Bakër

- Tirex Exploration
- Balkan Resources (Shqipëria Qendrore dhe Veriore)

→ Nikel

- Balkan Resources (Shqipëria Juglindore)

Kompanitë e përfshira në procesin e zbulimit paguajnë **taksa për sipërfaqen** dhe, potencialisht, **bonuse të nënshkrimit**.

Pagesat e deklaruara që kompanitë minerare kanë bërë dhe të ardhurat e deklaruara nga Shteti jepen në faqen 16 të këtij Raporti.

B. Grafiku i punës së bërë

Gjatë fazës së parë të punës sonë në Tiranë (“Faza paraprake”), 9-18 Mars 2011, ne u takuam me aktorë të ndryshëm aktivë të sektorit nxjerrës dhe palë të ndryshme të interesuara pjesëmarrëse në NTIN, për t’i ndërgjegjësuar lidhur me procesin e kuadrimin (bashkërendimit) dhe për të siguruar pjesëmarrjen më të lartë të mundshme.

Gjatë kësaj Faze Paraprake, ne diskutuam edhe për Objektivin e flukseve të Perfitimeve-avantazheve (benefit streams=zërat e pagesave të kompanive dhe të ardhurave të shtetit) (avantazheve) dhe të kompanive që do të merreshin në shqyrtim të Raporti për NTIN 2009, si dhe për Modelet (formulet) përkatëse të Raportimit. Diskutimet me Sekretariatit dhe Grupin Shqiptar të Punës të NTIN u zhvilluan në bazë të rekomandimeve tona, Rregullave të reja të NTIN, “Librit të Referencave për NTIN”, dokumenteve të ndryshme që na u paraqitën (Ligji Tatimor, Ligjet për Hidrokarburet dhe për Minierat, rregulloret, etj.), si dhe të analizës së rëndësishme materiale që bëri Sekretariati Shqiptar i NTIN. Në dhënien e rekomandimeve, ne mbajtëm parasysh afatin shumë të ngushtë në bazë të të cilit po punonte NTIN shqiptare lidhur me Raportin për NTIN 2009.

Vendimin përfundimtar për Objektivin e flukseve të përfitimeve (benefit streams=zërat e pagesave të kompanive dhe të ardhurat e shtetit) (avantazheve) dhe kompanive e mori Grupi i Punës në Tiranë më 11 Mars 2011. Ne arritëm të siguronim edhe Modelet (formulet) përkatëse të Raportimit të miratuara nga Grupi i Punës. Më pas, ne ua shpërndamë ato si Agjencie Shtetërore të Grumbullimit, ashtu dhe kompanive.

Faza vijuese e punës sonë konsistoi në krahasimin e të dhënave që morëm si nga kompanitë, ashtu dhe nga Agjencitë Shtetërore të Grumbullimit (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, AKBN dhe Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës). Krahasimi i të dhënave, që u bë në Paris në periudhën 1-6 Prill 2011, bëri të mundur që ne të krijojmë një bankë paraprake të dhënash, dhe të identifikojmë në mënyrë sistematike mospërputhjet që duheshin kuadruar, si dhe deklaratimet që mungonin.

Faza e fundit e punës sonë, që konsistonte në analizën dhe trajtimin e mospërputhjeve në fjalë (“Faza e kuadrimin”), parashikonte një vizitë të dytë në Tiranë që u zhvillua në datat 6-18 Prill 2011. Në këtë rast, ne u takuam me përfaqësues të çdo Agjencie Shtetërore të Grumbullimit dhe të disa kompanive që kishim si objektiv, me qëllim që deklaratimet, të cilat ndoshta mungonin, t’i merrnim në formatin e saktë, si dhe të finalizojmë punën për kuadrimin.

Pjesa II. Alternativa e Grupit të Punës lidhur me Objektivin e miratuar të Raportit për NTIN 2009 Shqipëri

Ky Raport është botuar në kuadrin e zbatimit në mënyrë progresive të Nismës në Shqipëri. Përcaktimi i Objektivit të flukseve të Perfitimeve (avantazheve) dhe të kompanive, që do të merren në shqyrtim në Raportin për NTIN 2009, është përgjegjësi vetëm e Grupit të Punës. Sidoqoftë, ne arritëm që të diskutojmë për këtë Objekt, të analizojmë elementet e rëndësishme materiale propozuar nga Sekretariati Shqiptar i NTIN, si dhe t'i jepnim Grupit të Punës disa rekomandime përpara miratimit të Objektivit përfundimtar më datë 11 prill 2011.

A. Sektori i natës

▪ Kompanitë që do të merreshin në shqyrtim

Ne jemi të vetëdijshëm që te Objekti për NTIN 2009 janë përfshirë të gjitha kompanitë, të cilat kanë qenë aktive në Shqipëri në vitin 2009:

→ Kompanitë private të naftës të përfshira në procesin e prodhimit

- Bankers Petroleum
- Stream Oil & Gas

→ Kompanitë private të naftës të përfshira në procesin e zbulimit

- Capricorn Albania
- IEC Visoka
- Island International Exploration
- Manas Adriatic
- Sherwood International
- Sky Petroleum

→ Kompania Kombëtare e Naftës

- Albpetroli

▪ Flukset e përfitimeve-avantazheve (pagesat e kompanive dhe të ardhurat e shtetit) që do të merreshin në shqyrtim

→ Pagesat e bëra nga kompanitë private

Jemi të vetëdijshëm që janë përzgjedhur të gjitha të ardhurat, të cilat konsiderohen të rëndësishme për kontratat shqiptare me ndarje prodhimi. Këto të ardhura janë në përputhje me praktikën e industrisë dhe rregullat e NTIN¹. Kompanitë, të cilat u ftuan për të deklaruar ndonjë pagesë tjetër të rëndësishme që mund t'i kenë bërë Shtetit, nuk bënë asnjë deklaram për ndonjë fluks të rëndësishëm perfitimesh (avantazhesh) jashtë Objektivit të përcaktuar.

¹ Ne sollëm në vëmendje të Grupit të Punës mungesën e taksave për sipërfaqen në Objektivin e të ardhurave nga nafta; si kompanitë ashtu dhe Shteti konfirmuan se, në Shqipëri, kjo lloj pagese e zakonshme nuk zbatohet në sektorin e naftës.

Këtu jepen lista dhe përkufizimi i flukseve të Perfitimeve-avantazheve(benefit streams=zërat e pagesave të kompanive dhe të ardhurave të shtetit) që përfshihen te Objekti për NTIN 2009 për sektorin privat të naftës:

Përkufizimi i pagesave të bëra nga kompanitë private të naftës – Objekti për NTIN-ënë 2009

- **Bonuset e nënshkrimit**

Herë pas here, bonuset e nënshkrimit përcaktohen (në bazë të negociatave kontraktuale) kur jepen lejet e zbulimit apo licensat e prodhimit, sipas kushteve dhe afateve të veçanta kontraktuale.

Bonuset e nënshkrimit i mbledh si Albpetroli (për nënshkrimin e licensave të prodhimit), ashtu dhe AKBN (për nënshkrimin e lejeve të zbulimit).

- **Renta minerare**

Renta minerare zbatohet për vlerën e tatueshme (ose vlerën fiskale) të shitjeve.

Rentën për eksportin e produkteve minerare e mbledh Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ndërsa rentën për shitjen e produkteve minerare brenda vendit e mbledh Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

- **Pjesa nga ndarja e prodhimit që i shkon Kompanisë Kombëtare të Naftës**

Albpetroli, Kompanisë Kombëtare të Naftës, i takon të marrë një pjesë nga ndarja e prodhimit. Kjo pjesë e ndarë përcaktohet sipas një kontrate, në bazë të prodhimit të vlerësuar (prodhimit paraekzistues) dhe prodhimit të shtuar (prodhimit që përftohet nga investimi i kontraktuesit). Pagesa për pjesën nga ndarja e prodhimit, që i shkon Albpetroli, mund të bëhet me para në dorë ose në natyrë (fuçi nafte).

- **Tatimi mbi fitimin e shoqërive**

Tatim-fitimi i shoqërive përllogaritet në bazë të fitimit të tatueshëm të kompanisë.

Tatimi-fitimi mbledhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.


- **Pagesa të tjera të rëndësishme që i bëhen Shtetit**

Për të siguruar përfshirjen e plotë dhe identifikimin e flukseve të avantazheve të rëndësishme që mund të mungojnë, kompanitë u ftuan që të deklaronin, mbi baza vullnetare, çdo pagesë që i është bërë Shtetit ose subjekteve të tij, të cilën ato do ta konsideronin si të rëndësishme.

→ Të ardhurat e marra dhe pagesat e bëra nga Albpetroli

Albpetroli, si Kompani Kombëtare e Naftës, merr një **pjesë nga ndarja e prodhimit** për investimet e bëra përpara nënshkrimit me kompanitë private të kontratave me ndarje prodhimi (prodhimi i vlerësuar ose prodhimi paraekzistues), dhe një **pjesë nga ndarja e prodhimit** në emër të Shtetit. Gjithashtu, Albpetroli merr **bonuse të nënshkrimit** për nënshkrimin e licensave të prodhimit. Pastaj, Albpetroli mund t'ia rishpërndajë disa të ardhura Shtetit nëpërmjet pagesës së **tatim-fitimit** dhe të **dividendëve**.

Ky grafik tregon rrjedhjet e Flukseve të Perfitimeve-avantazheve (benefit streams=zërat e pagesave të kompanive dhe të ardhurave të shtetit) të përzgjedhura nga Grupi i Punës për Albpetrolin dhe Shtetin.



Në këtë kontekst, pagesat që i ka bërë Albpetroli Shtetit, Grupi i Punës i ka përkufizuar kështu:

Përkufizimi i pagesave të bëra nga Albpetroli – Objekti për NTIN-ënë 2009

- Tatimi mbi fitimin e shoqërive (tatim-fitimi)**
 Tatimi mbi fitimin e shoqërive përlogaritet në bazë të fitimit të tatueshëm të kompanisë.
Tatimin mbi fitimin e shoqërive e mbledh Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
- Dividendët**
 Dividendët përkojnë me fitimet e Kompanisë Kombëtare të Naftës, të cilat i rishpërndahet Shtetit si aksionar i vetëm. Niveli i dividendëve përcaktohet nga Bordi (këshilli) i kompanisë.
- Pagesa të tjera të rëndësishme që i bëhen Shtetit**
 Për të siguruar përfshirjen e plotë dhe identifikimin e flukseve të avantazheve të rëndësishme që mund të mungojnë, kompanitë u ftuan që të deklaronin, mbi baza vullnetare, çdo pagesë që i është bërë Shtetit ose subjekteve të tij, të cilën ato do ta konsideronin si të rëndësishme.

B. Sektori i minierave

Në vitin 2009, të gjitha kompanitë aktive në Shqipëri, ishin private.

▪ Kompanitë që do të merreshin në shqyrtim

Ne jemi të vetëdijshëm që kompanitë, të cilat ishin të përfshira në procesin e prodhimit dhe do të përfshiheshin te Objekti, ishin përzgjedhur nga Grupi i Punës në bazë të nivelit të veprimtarisë së tyre, domethënë:

→ Kromi

Kompanitë prodhuese të kromit u përzgjedhën nga Grupi i Punës në bazë të nivelit të veprimtarisë së tyre. Niveli i veprimtarisë u përcaktua duke patur parasysh nivelin e tyre zyrtar të prodhimit, mbi pragun e prodhimit prej 2 000 ton/vit.

- | | |
|---------------------------------|-----------------|
| - ACR (Albanian Chrome) | - Klervibris |
| - Alb-Canaj | - Klosi |
| - Alba-Co | - Koka |
| - Ateani | - Krypi |
| - Bledi | - L.B.M. |
| - Egi-K | - Neli |
| - Fabrika e Pasurimit të Kromit | - Ral |
| - Gentari | - Shkalla |
| - Geri's 2002 | - Shkëmbi |
| - Geri Trevi | - Mineral Tadri |
| - Herbi | - Xhireton |
| - 11 Heronjtë e Batrës | - Ylberi |
| - Isaku | - Zguri |

→ Bakri

Kompanitë prodhuese të bakrit u përzgjedhën nga Grupi i Punës në bazë të nivelit të veprimtarisë së tyre. Niveli i veprimtarisë u përcaktua duke patur parasysh nivelin e tyre zyrtar të prodhimit, mbi pragun e prodhimit prej 114 000 ton mineral bakri i nxjerrë (përpara procesit të pasurimit).

- Ber Alb

→ Nikeli

Kompanitë prodhuese të nikelit u përzgjedhën nga Grupi i Punës në bazë të nivelit të veprimtarisë së tyre. Niveli i veprimtarisë u përcaktua duke patur parasysh nivelin e tyre zyrtar të prodhimit, mbi pragun e prodhimit prej 5 000 ton/vit.

- | | |
|--------------|----------------------|
| - Alfa Nikel | - Prodhime Karbonike |
| - Dollar Oil | - Rej |
| - K-12 | - YZO |

Ne jemi të vetëdijshëm se janë përzgjedhur të gjitha kompanitë ndërkombëtare, të cilat ishin të përfshira në procesin e zbulimit. Këto kompani kanë projekte për:

- Kromin
 - Empire Mining Albania
 - Jab Resources
- Bakrin
 - Tirex Exploration
 - Balkan resources (Shqipëria Qendrore dhe Veriore)
- Nikelin
 - Balkan Resources (Shqipëria Juglindore)

▪ **Flukset e Përfitimeve-avantazheve (pagesat dhe te ardhurat) që duhen marrë në shqyrtim**

Ne jemi të vetëdijshëm se janë përzgjedhur të gjitha të ardhurat e rëndësishme specifike që mendohen nga marrëveshjet koncesionare për minierat shqiptare. Këto të ardhura janë në përputhje me praktikat e industrisë dhe Rregullat e NTIN. Kompanitë, të cilat u ftuan që të bënin deklarime për ndonjë pagesë tjetër të rëndësishme që mund t'i kenë bërë Shtetit, nuk deklaruan ndonjë fluks të rëndësishëm të Përfitimeve (avantazheve) jashtë Objektivit.

Këtu jepen lista dhe përkufizimi i flukseve të avantazheve që përfshihen te Objekti për NTIN 2009 për sektorin e minierave.

Përkufizimi i pagesave të bëra nga kompanitë minerare – Objekti për NTIN 2009

• **Bonuset e nënshkrimit**

Herë pas here, bonuset e nënshkrimit përcaktohen (në bazë të negociatave kontraktuale) kur jepen lejet e zbulimit apo licensat e shfrytëzimit, sipas kushteve dhe afateve të veçanta kontraktuale.

Bonuset e nënshkrimit i mbledh AKBN.

• **Taksat për sipërfaqen**

Taksat për sipërfaqen janë tatime që paguajnë mbajtësit e licensave të zbulimit apo të prodhimit sipas sipërfaqes gjeografike.

Taksat për sipërfaqen i mbledh Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës.

• **Renta minerare**

Renta minerare (që njihet gjithashtu si tatim mbi “sipas vlerës”) zbatohet për vlerën tatueshme (ose vlerën fiskale) të shitjeve.

Rentën për eksportin e produkteve minerare e mbledh Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ndërsa rentën për shitjen e produkteve minerare brenda vendit e mbledh Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

- **Tatimi mbi fitimin e shoqërive-Tatim-fitimi**

Tatimi mbi fitimin e shoqërive përlogaritet në bazë të fitimit të tatueshëm të kompanisë.

Tatimin mbi fitimin e shoqërive e mbledh Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

- **Pagesa të tjera të rëndësishme që i bëhent Shtetit**

Për të siguruar përfshirjen e plotë dhe identifikimin e flukseve të avantazheve të rëndësishme që mund të mungojnë, kompanitë u ftuan që të deklaronin, mbi baza vullnetare, çdo pagesë që i është bërë Shtetit ose subjekteve të tij, të cilën ato do ta konsideronin si të rëndësishme.

C. Formularët e deklarimit (Modelet e Raportimit) të zgjedhura për NTIN-ënë 2009

Formularët e deklarimit, për përdorim nga Qeveria dhe kompanitë, u përpiluan nga ekipi ynë, në përputhje me përvojat më të mira ndërkombëtare, në bazë të Objektivit të NTIN, siç e ka përcaktuar Grupi i Punës për vitin 2009.

Formularët e deklarimeve u diskutuan me Grupin e Punës dhe u miratuan nga ai. Më tej, ne ua shpërndamë drejtëpërsedrejt të gjitha kompanive që përfshinte Objekti, si dhe Agjencive Shtetërore të Grumbullimit.

Në përputhje me rekomandimet e Rregullave të reja të NTIN dhe “Librit të Referencave për NTIN”, Grupi i Punës e bëri të qartë se:

- Deklarimet duhet të bëhen në monedhën në të cilën janë realizuar flukset e perfitimeve (avantazheve) financiare (lekë, dollarë amerikanë, Euro etj.);
- Deklarimet duhet të përkojnë me pagesat reale që kanë bërë kompanitë (në bazë të parave dhe jo në bazë të akumulimit-accrual basis);
- Në kuadrin e zbatimit të Veprimit të Rekomanduar 18 të “Librit të Referencave për NTIN-ënë” dhe Kërkesës së re 12 të NTIN-ësë, kontribuesi kryesor në sektorin e naftës (Bankers Petroleum) u ftua që të paraqiste deklarimet e verifikuara nga auditori i tij i jashtëm;
- Deklarimet e Shtetit dhe të kompanive, që nuk kërkohet të verifikohen nga auditorë të jashtëm, duhet të nënshkruheshin nga Menaxheri i Përgjithshëm i çdo institucioni, i cili tregon angazhimin e tij personal ndaj saktësisë së të dhënave që jepen.

la vlen të përmendet se kompanitë, të cilat u morën në shqyrtim për efekt të Raportit për NTIN-2009, nuk kanë asnjë detyrim kontraktual për të bërë deklarime. Këto kompani i paraqitën formularët e deklarimeve vetëm në bazë të vullnetit të tyre të lirë. Deri në vitin 2009, NTIN shqiptare, faktikisht, është mbështetur në parimin e pjesëmarrjes vullnetare.

Pjesa III. Natyra dhe niveli i punës që kemi bërë

Ne patëm si detyrë që të grumbullonim, kuadronim dhe përpilonim të dhënat për flukset e angazhimeve që Shteti ka deklaruar se ka marrë, si dhe flukset e angazhimeve që kompanitë kanë deklaruar se kanë paguar, në bazë të Objektivit të Raportit për NTIN 2009 që përmendet më lart.

Deklarimet për këto të dhëna u përgatitën nën përgjegjësinë, përkatësisht, të përfaqësuesve të Qeverisë (të ardhurat shtetërore) dhe të përfaqësuesve të çdo kompanie (pagesat që i janë bërë Shtetit), të cilët na i kthyen drejtëpërsëdrejti neve formularët e deklarimeve të tyre.

Tani, në formë të konsoliduar, për çdo fluks të avantazheve që është marrë në shqyrtim sipas Objektivit të Raportit për NTIN 2009, ne po ju paraqesim flukset e avantazheve që kompanitë kanë deklaruar se kanë paguar, si dhe ato që Shteti ka deklaruar se ka marrë. Ndonëse nuk është detyra jonë që të japim shpjegim për mospërputhjet që mbeten pas kuadrimin të të dhënave të konsoliduara që janë marrë nga Shteti dhe kompanitë (kuadrimi i të dhënave të deklaruara).

Mandati ynë nuk nënkupton auditim, as shqyrtim të kufizuar të flukseve të avantazheve në sektorët e naftës dhe të minierave. Për më tepër, nuk është pjesë e mandatit tonë as auditimi apo verifikimi i të dhënave që na janë dhënë neve. Pra, nuk pritet që ne të bëjmë të njohura gabimet, veprimet e kundraligjshme apo çrregullime të tjera.

Përkufizimet e flukseve të avantazheve për qëllimin e Raportit për NTIN-ënë 2009 u formuluan nga Grupi i Punës në bazë të diskutimeve që ka zhvilluar ai, dhe pas shqyrtimit të legjislacionit tatimor dhe ligjeve për hidrokarburet dhe minierat. Nuk është pjesë e mandatit tonë që të verifikojmë tërësinë e flukseve të Perfitimeve-avantazheve (benefit streams=zërat e pagesave të kompanive dhe të ardhurave të shtetit) që merren në shqyrtim sipas Objektivit të Raportit për NTIN-ënë.

Grupi i Punës vuri në dukje edhe cilat kompani duhet të merreshin në shqyrtim të Raportit për NTIN-ënë 2009. Gjithashtu, nuk është në kompetencën tonë që të verifikojmë tërësinë e kompanive të marra në shqyrtim sipas Objektivit.

Megjithatë, ne kemi për detyrë të bëjmë kujdes që përkufizimet e flukseve të avantazheve, të marra në shqyrtim për qëllimin e Raportit për NTIN-ënë 2009, të jenë në përputhje me ato që ilustrohen në Rregullat e reja të NTIN, "Libri i Referencave për NTIN-ënë" dhe me ato që pranohen gjerësisht në industrinë e naftës dhe të minierave në shkallë ndërkombëtare.

Për qëllimin e plotësisht të deklarimeve të tyre, ne gjithashtu duhet të verifikojmë që përkufizimet ishin kuptuar në mënyrë korrekte si nga përfaqësuesit e kompanive, ashtu dhe nga përfaqësuesit e Qeverisë (përceptimi global i Objektivit të Raportit për NTIN).

Ne kemi bërë këtë punë:

- Analizën e qëndrueshmërisë së Objektivit të Raportit për NTIN-ënë, siç e ka përcaktuar Grupi i Punës;
- Verifikimin se përkufizimet e flukseve të avantazheve, që do të deklaroheshin (pagesat e bëra nga kompanitë dhe të ardhurat e Shtetit), iu komunikuan përfaqësuesve të Qeverisë (të ardhurat e Shtetit) dhe përfaqësuesve të kompanive (pagesat që i bëhen Shtetit) dhe u kuptuan prej tyre;

- Pranimin (kërkesat dhe letrat plotësuese që u dorëzuan) e formularëve të deklarimeve që dorëzuan kompanitë, ku tregohen në mënyrë të hollësishme pagesat e bëra Shtetit në vitin 2009. Këto deklarime janë bërë në bazë të Objektit të miratuar të Raportit për NTIN 2009 dhe të Modeleve të miratuara të Raportimit;
- Pranimin e formularëve të deklarimeve që dorëzoi Qeveria, ku tregohen në mënyrë të hollësishme të ardhurat që ka marrë Shteti në vitin 2009. Këto deklarime janë bërë në bazë të Objektit të miratuar dhe të Modeleve të miratuara të Raportimit;
- Kuadrimin (bashkërendimin, përputhjen) e të dhënave që kanë dhënë kompanitë dhe atyre që ka dhënë Shteti. Për qëllime të koherencës, ky kuadrim i të dhënave u krye duke patur parasysh vetëm kompanitë, të cilat i kanë dorëzuar deklarimet e tyre deri në datën e botimit të këtij Raporti;
- Paraqitjen, në mënyrë të konsoliduar, të kuadrimin të të dhënave të ofruara nga Shteti dhe atyre të ofruara nga kompanitë për çdo fluks të Perfitimeve-avantazheve (benefit streams=zërat e pagesave të kompanive dhe të ardhurave të shtetit) që është marrë në shqyrtim për NTIN 2009, duke bërë dallimin mes sektorit të naftës dhe sektorit të minierave.

Pjesa IV. Kuadrimi (bashkerendimi, perputhja) i të dhënave për sektorin e naftës

A. Kompanitë pjesëmarrëse të naftës që u morën në shqyrtim sipas Objektivit të Raportit për NTIN-ënë 2009

Të gjitha kompanitë e naftës na i dorëzuan deklaratimet e tyre. Ato janë këto:

- Albpetrol
- Bankers Petroleum
- Capricorn Albania
- IEC Visoka
- Island International Exploration
- Manas Adriatic
- Sherwood International
- Sky Petroleum
- Stream Oil & Gas

Me kërkesën tonë dhe në përputhje me Objektivin e Raportit për NTIN-ënë 2009, Bankers Petroleum, kontribuesi kryesor në buxhetin e shtetit nga industria nxjerrëse, dorëzoi pranë nesh deklaratimet e verifikuara nga auditori i tij i jashtëm ndërkombëtar. Verifikimi i deklaratimeve të *Bankers Petroleum* është hapi i parë që ndërmerret në zbatim të Nismës në Shqipëri. Dhe, në kuadrin e zbatimit hap pas hapi të NTIN, një përvojë e tillë duhet shtrirë te kompanitë e tjera sipas Objektivit të Raportit të mëtejshme për NTIN.

Tabelë e kuadrimit të deklaratimeve në kuadrin e NTIN-ësë në sektorin e naftës (në mijëra dollarë amerikanë)

Ref. ²	(Në mijë dollarë amerikanë)	kompanitë private të naft	Albpetroli	Shteti	Δ
A	Bonuset e nënshkrimit (faza e zbulimit)	160	-	160	0
B	Rentat minerare	8 828	-	8 175	653
C	Tatimi mbi fitimin e shoqërive (shoqëritë priv)	0	-	0	0
D	Bonuset e nënshkrimit (faza e prodhimit)	0	50	-	(50)
E	Pjesa e ndarë e prodhimit për Albpetrolin	22 915 ³	22 915 ³	-	0
F	Tatimi mbi fitimin e shoqërive (Albpetroli)	-	0	0	0
G	Dividendët (Albpetroli)	-	0	0	0
GJITHSEJ		31 903	22 965	8 335	

² Çdo fluks i avantazheve, që paraqitet në këtë tabelë, mund të lidhet me paraqitjen e fluksit të pagesave dhe të ardhurave të sektorit të naftës në faqen 9.

³ Nga 22.9 milion dollarët e pjesës nga ndarja e prodhimit, 14.6 milion dollarë janë paguar në dorë dhe 8.3 milion dollarë janë paguar në natyrë.

Pjesa V. Kuadrimi (bashkëndimi, përputhja) i të dhënave për sektorin e minierave

A. Kompanitë pjesëmarrëse minerare që u morën në shqyrtim sipas Objektivit të Raportit për NTIN 2009

Këto janë kompanitë minerare që dorëzuan deklaratimet e tyre pranë nesh:

- | | |
|---------------------------------|----------------------|
| - ACR / Albanian Chrome | - K-12 |
| - Alb-Canaj | - Klosi |
| - Alba-Co | - Koka |
| - Alfa Nikel | - Krypi |
| - Ateani | - L.B.M |
| - Balkan Resources | - Neli |
| - Ber Alb | - Prodhime Karbonike |
| - Bledi | - Ral |
| - Egi-K | - Rej |
| - Empire Mining Albania | - Shkalla |
| - Fabrika e Pasurimit të Kromit | - Mineral Tadri |
| - Geri Trevi | - Tirex Exploration |
| - Herbi | - Xhireton |
| - 11 Heronjtë e Batrës | - Ylberi |
| - Isaku | - YZO |
| - Jab Resources | - Zguri |

Tabela e kuadrimit të deklaratimeve në kuadrin e NTIN-ësë në sektorin e minierave (në milion lekë)

<i>(në mijë lekë)</i>	Kompanitë	Shteti	Δ
Bonuset e nënshkrimit	0,2	0,1	0,1
Taksat për sipërfaqen	12,2	12,1	0,1
Rentat minerare	93,1	92,5	0,6
Tatimi mbi fitimin e shoqërive	86,2	81,4	4,8
GJITHSEJ	191,7	186,1	5,6

B. Kompanitë minerare, të shqyrtuara sipas Objektivit të Raportit për NTIN 2009, të cilat nuk morën pjesë

Një numër i vogël kompanish minerare, të cilat përfshiheshin në Objektivin e Raportit për NTIN-ënë 2009, nuk i dorëzuan deklaratimet e tyre pranë nesh. Këto kompani janë këto:

- Dollar Oil
- Klervibris
- Gentari
- Shkëmbi
- Geri's 2002

Sidoqoftë, veprimtaria e këtyre kompanive është shumë e kufizuar, dhe kontributi i tyre tek të ardhurat e Shtetit, nuk ka gjasa që të jetë i rëndësishëm.

Pjesa VI. Konkluzione: komente dhe rekomandime

A. Konkluzione

Këto komente mbështeten te informacioni që na vuri në dispozicion deri në këtë datë, Grupi i Punës, Qeveria dhe kompanitë që veprojnë në sektorët e naftës dhe të minierave:

1. Përkufizimet e flukseve të Perfitimeve-avantazheve (pagesat e bëra nga kompanitë dhe të ardhurat e Shtetit), siç propozohen nga Grupi i Punës, janë në përputhje me përkufizimet e Rregullave të reja të NTIN, të “Librit të Referencave për NTIN” dhe përkufizimet e pranuar gjerësisht në industrinë e naftës dhe të minierave.
2. Përkufizimet e flukseve të avantazheve iu komunikuan përfaqësuesve të Qeverisë dhe përfaqësuesve të kompanive që veprojnë në sektorët e naftës dhe të minierave.
3. Qeveria dhe kompanitë i kanë bërë deklaratimet e tyre në bazë të këtyre përkufizimeve.
4. Deklarimet e bëra nga Bankers Petroleum, kontribuesi kryesor në sektorin e naftës, janë verifikuar nga auditori i tij i jashtëm ndërkombëtar, në bazë të standardeve ndërkombëtare të auditimit.
5. Kuadrimi (bashkerendimi, perputhja) i deklaratimeve që kanë bërë kompanitë dhe Qeveria, nuk nxori ndonjë anomali të rëndësishme.

B. Komente dhe rekomandime për deklaratimet e bëra nga kompanitë

Informacioni i dhënë nga kompanitë u grumbullua brenda kuadrit kohor të caktuar për këtë qëllim, dhe në përputhje me standardet e parashtruara te udhëzuesit për Modelet (formulet) e Raportimit.

Verifikimi i deklaratimeve të Bankers Petroleum nga auditori i tij i jashtëm ndërkombëtar, sipas Kërkesës 12 të Rregullave të reja të NTIN-ësë dhe Veprimit të Rekomanduar 18 të “Librit të Referencave për NTIN-ënë”, është një hap i rëndësishëm drejt vendosjes së besueshmërisë së Nismës në Shqipëri. Për qëllimet e Raporteve të ardhshme për NTIN, ne rekomandojmë që verifikimi i deklaratimeve në kuadrin e NTIN të bëhet rregull për kompanitë kryesore minerare dhe të naftës.

C. Komente dhe rekomandime për deklaratimet që bën Qeveria

Dorëzimi i deklaratimeve nga ana e Agjensive Shtetërore të Grumbullimit u bë me vonesë. Sidoqoftë, këto institucione bashkëpunuan në mënyrë të efektshme me ne për kryerjen e punës për kuadrimin (bashkerendimin, perputhjen) e të dhënave.

Mospërputhjet (ndryshimet) që mbeten, për të cilat flitet në Raport (sidomos mospërputhjet lidhur me rentat minerare në sektorin e naftës), mund të shpjegohen kryesisht me kufizimet që ka sistemi i informacionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, si dhe vështirësinë e saj për të dhënë informacion të hollësishëm për tremujorin e parë të vitit 2009. Kufizimi i

përdorimit të fletës që plotësohet me dorë, si dhe zgjedhja e procesit të transferimit të të dhënave dhe dorëzimi i dokumentacionit në mënyrë elektronike, siç është përcaktuar në këtë Drejtori qysh në muajin prill 2009, me siguri do të shërbejnë për të përmirësuar cilësinë e deklarimeve që bën Qeveria në kuadrin e Raporteve të ardhshme për NTIN.

D. Komente dhe rekomandime të tjera lidhur me Raportet e ardhshme për NTIN

- Pagesat e TVSH-ësë (Taksa e Vlerës së Shtuar) që ka bërë Albpetroli

Gjatës fazës së kuadrimit dhe pas përcaktimit të Objektivit të Raportit për NTIN 2009, kuptuam se disa pagesa të TVSH-ësë nga Albpetroli janë bërë në bazë të vlerës së pjesës nga ndarja e prodhimit që ka marrë nga kompanitë private të naftës. Ndërsa duket se, për të gjitha kompanitë e tjera, përjashtimi nga TVSH-ja (ose TVSH-ja zero) është vendosur me ligj, pagesat e TVSH që ka bërë Albpetroli janë një formë e kthimit të pjesës nga ndarja e prodhimit Shtetit. Ne verifikuam se, në vitin 2009, pagesat e TVSH së bërë nga Albpetroli arrinin në 4 000 000⁴ lekë; pra, në vitin 2009, ato nuk përfaqësonin ndonjë të ardhur të rëndësishme për Shtetin. Megjithatë, ne rekomandojmë që ky fluks Perfitimeve-avantazheve (benefit streams=zërat e pagesave të kompanive dhe të ardhurave të shtetit) të përfshihet në Objektivin e Raporteve të ardhshme për NTIN.

- Përlllogaritja e kohës për raportimin lidhur me NTIN.

Përfundimisht, do të ishte më e përshtatshme nëse, në kuadrin e NTIN, procesi i raportimit dhe kuadrimit do të realizohej duke filluar nga muaji shtator pas vitit në të cilin duhet të mbështetet çdo Raport për NTIN. Në mënyrë të veçantë, kjo do të siguronte një pjesëmarrje më të mirë të kompanive, si dhe perceptimin në kohë të të ardhurave të Shtetit nga ana e palëve të ndryshme të interesuara, perceptim ky që bazohet te NTIN.

⁴ Në bazë të informacionit të dhënë nga Albpetroli.